

SHËNIMET SHPJEGUESE TË NJËSIVE EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME	
SKK 1	KUADRI I PËRGJITHSHËM PËR PËRGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE
99	Një ndryshim në politikat kontabël do të zbatohet në retrospektivë, duke u kthyer prapa deri në fillimin e periudhës më të hershme të paraqitur, përveç rasteve kur (a) një ndryshim në politikën kontabël ka ardhur nga një SKK i ri dhe aty janë përshkruar dispozita të ndryshme për metodën e kalimit në politikën e re, ose (b) efekti i ndryshimit të politikës kontabël, në periudhat kontabël të mëparshme, nuk mund të vlerësohet me besueshmëri.
99A	<u>Njësitë ekonomike të vogla përjashtohen nga zbatimi i paragrafit 99. Këto njësi i zbatojnë ndryshimet në politikat kontabël në prospektivë.</u>
116	Kontabilizimi i ngjarjeve që ndodhin pas mbylljes së periudhës raportuese, por para datës kur pasqyrat financiare autorizohen për t'u publikuar, varet nga fakti nëse këto ngjarje janë të tilla që kërkojnë rregullim ose jo.
117	Ngjarja pas periudhës raportuese për të cilën duhet të bëhen rregullime, është një ngjarje që evidenton kushte që kanë ekzistuar në datën e mbylljes së periudhës raportuese. Një njësi ekonomike duhet të rregullojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve përkatëse shpjeguese, për të pasqyruar ngjarjet rregulluese pas përfundimit të periudhës raportuese.
118	Ngjarjet, për të cilat nuk bëhen rregullime janë ngjarjet që nuk evidentojnë kushtet që kanë ekzistuar pas mbylljes së periudhës raportuese. Njësia ekonomike nuk do të korrigjojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për të reflektuar ngjarjet për të cilat nuk bëhen rregullime, pas përfundimit të periudhës raportuese. Efekti i ngjarjeve për të cilat nuk bëhen rregullime do të përshkruhet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nëse ato janë materiale.
118A	<u>Paragrafët 116-118 nuk janë të zbatueshëm nga njësitë ekonomike të vogla, të përcaktuara si të tilla në ligjin për kontabilitetin.</u>
SHËNIMET SHPJEGUESE	
120.	Njësia ekonomike duhet të paraqesë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare një përmbledhje të politikave kryesore kontabël, të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare.
121.	Në rastet kur një ndryshim i këtij Standardi ndikon në periudhën aktuale ose ndonjë periudhë të mëparshme, apo mund të ketë një efekt në periudhat e ardhshme, njësia ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues në vijim: (a) llojin e ndryshimit në politikën kontabël; (b) për periudhën aktuale dhe çdo periudhë të mëparshme të paraqitur, deri në masën e mundshme, shumën e rregullimit për çdo zë të prekur të pasqyrave financiare; (c) shumën e rregullimit që lidhet me periudhat para atyre të paraqitura, për aq sa është e zbatueshme; (d) një shpjegim në rastet kur është i pazbatueshëm përcaktimi i shumave të deklaruara në (b) ose (c) më sipër; Pasqyrat financiare të periudhave të mëpasshme nuk duhet të përsërisin këto informacione shpjeguese.
121A	<u>Kërkesat e paragrafit 121 nuk janë të zbatueshme për njësitë ekonomike të vogla, të përcaktuara si të tilla në ligjin për kontabilitetin.</u>
122.	Në rastet kur një ndryshim i vullnetshëm në politikën kontabël ndikon në periudhën aktuale ose në ndonjë periudhë të mëparshme, njësia ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues në vijim: (a) llojin e ndryshimit në politikën kontabël; (b) arsyet se përse zbatimi i politikës së re kontabël siguron informacion të besueshëm dhe më të përshtatshëm; (c) për aq sa është e zbatueshme, shumën e rregullimit për çdo zë të prekur të pasqyrave financiare, treguar veçmas: (i) për periudhën aktuale; (ii) për secilën periudhë të mëparshme të paraqitur; dhe (iii) në total për periudhat para atyre të paraqitura.
123.	Nëse mënyra e paraqitjes së politikave kontabël dhe/ose informacionit kontabël ka ndryshuar, atëherë në shënimet shpjeguese do të shpjegohet: (a) përshkrimi i ndryshimit dhe arsyetja e ndryshimit; (b) efekti i tij mbi zërat e pasqyrës së pozicionit financiar dhe pasqyrës së performancës financiare; (c) nëse ndryshimi nuk është njohur në retrospektivë, do të jepet shpjegimi i situatës, përshkrimi i efektit të politikës së re, si dhe ushtrimet e mëparshme të ndikuara nga ndryshimi.
123A	<u>Kërkesat e paragrafëve 122 dhe 123 janë të zbatueshme për njësitë ekonomike të vogla vetëm në rastet kur:</u> - <u>një ndryshim i vullnetshëm në politikën kontabël ndikon në periudhën aktuale ose në ndonjë periudhë të mëparshme apo</u> - <u>nëse mënyra e paraqitjes së politikave kontabël dhe/ose informacionit kontabël ka ndryshuar</u>

	<u>Njësiti ekonomike të vogla duhet të japin informacionin shpjegues në vijim: (a) llojin e ndryshimit në politikën kontabël ose ndryshimit në paraqitjen e informacionit financiar; (b) arsyet se përse zbatimi i politikës së re kontabël apo paraqitjes së re sigurojnë informacion të besueshëm dhe më të përshtatshëm;</u>
124.	Në ato raste kur, për hir të një paraqitje sa më të vërtetë e të besueshme, dispozitat e disa Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit nuk janë zbatuar, atëherë në shënimet shpjeguese do të shpjegohet: (a) dispozita e SKK-së që nuk është ndjekur; (b) arsyet për mosndjekjen e saj; (c) efekti mbi zërat e pasqyrës së pozicionit financiar dhe të pasqyrës së performancës financiare.
<u>124A</u>	<u>Kërkesa e parashikuar në paragrafin 124, pika c, nuk është e zbatueshme për njësiti ekonomike të vogla.</u>
125.	Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese mbi llojin e çdo ndryshimi në vlerësimin kontabël dhe efektin e ndryshimit në aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën aktuale. Nëse njësia ekonomike mund të vlerësojë efektin e ndryshimit në një ose më shumë periudha të ardhshme, atëherë duhet të japë informacione shpjeguese për këto vlerësime. <u>Përfshijmë njësiti ekonomike të vogla të cilat nuk japin shpjegime të mëtejshme për të shpjeguar efektin e ndryshimeve të vlerësimeve kontabël në periudhat e ardhshme.</u>
126.	Në ato raste, kur zbulohen gabime materiale nga ushtrimet të mëparshme, në shënimet shpjeguese do të paraqitet: (a) lloji i gabimit të periudhës së mëparshme; (b) për secilën periudhë të mëparshme të paraqitur, për aq sa është e zbatueshme, shuma e korigjimit për çdo zë të prekur të pasqyrave financiare; (c) për aq sa është e zbatueshme, shuma e korigjimit në fillim të periudhës më të hershme të mëparshme të paraqitur; (d) një shpjegim nëse nuk është i zbatueshëm përcaktimi i shumave të shpjeguara në (b) ose (c) më sipër. Pasqyrat financiare të periudhave të mëpasshme nuk duhet të përsërisin këto informacione shpjeguese.
<u>126A</u>	<u>Njësiti ekonomike të vogla, në rastet kur zbulohen gabime materiale, paraqesin në shënimet shpjeguese llojin e gabimit të periudhës së mëparshme dhe efektin e korigjimit të tij në aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën aktuale.</u>
127.	Në shënimet shpjeguese duhet të përshkruhen ngjarjet materiale për të cilat mund të bëhen rregullime pas përfundimit të periudhës raportuese si dhe efekti i tyre mbi shifrat financiare të paraqitura në pasqyrat financiare.
128.	Njësia ekonomike duhet të japë informacionet e mëposhtme shpjeguese për çdo kategori ngjarjeje pas përfundimit të periudhës raportuese, që nuk mund të rregullohet: (a) llojin e ngjarjes; (b) një vlerësim të efektit të saj financiar; (c) një deklaratë që një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet.
<u>128A</u>	<u>Kërkesat e paragrafëve 127 dhe 128 nuk janë të zbatueshme për njësiti ekonomike të vogla.</u>
129.	Nëse ka pasiguri në lidhje me vazhdimësinë e veprimtarisë së njësies ekonomike, në shënimet shpjeguese duhet të jepen faktorët që shkaktojnë këtë pasiguri. Nëse pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e likuidimit të operacioneve të njësies ekonomike, atëherë do të shpjegohet arsyeja dhe baza e përgatitjes.
SKK 2	PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE
90.	Një njësi ekonomike duhet të japë informacione në shënimet shpjeguese rreth supozimeve kyçe lidhur me të ardhmen, dhe burime të tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e raportimit, të cilat ka shumë mundësi të sjellin një rregullim material në vlerat kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Përsa i përket këtyre aktiveve dhe detyrimeve, shënimet shpjeguese duhet të përfshijnë detajet e: (a) natyrës së tyre; (b) vlerës së tyre kontabël në fund të periudhës raportuese.
<u>90A</u>	<u>Njësiti ekonomike të vogla përfshihen nga zbatimi i paragrafit 90.</u>
SKK 3	INSTRUMENTET FINANCIARE
	SHËNIMET SHPJEGUESE
38.	Një njësi ekonomike duhet të japë informacion për vlerën kontabël të secilit prej kategorive vijuese të aktiveve dhe detyrimeve financiare (në total) në datën e raportimit, ose në pasqyrën e pozicionit financiar, ose në shënimet shpjeguese: (a) aktivet financiare që janë instrumente borxhi të matura me koston e amortizuar (paragrafi 15(a)). (b) detyrime financiare të matura me koston e amortizuar (paragrafi 15(a)).

	(f) zotime huaje të matura me kosto minus zhvlerësim (paragrafi 15(b)).
39.	Një njësi duhet të japë informacion shpjegues që i jep mundësi përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë rëndësinë që kanë instrumentet financiare në pozicionin dhe performancën e vetë njësisë. Për shembull, informacioni për huanë afatgjatë normalisht do të përfshinte afatet dhe kushtet e instrumentit të borxhit (si norma e interesit, maturimi, grafiku i ripagimit dhe kufizimet që instrumenti i borxhit i imponon njësisë).
	<i>Çregjistrimi</i>
40.	Nëse një njësi i ka transferuar aktivet financiare një pale të tretë në një transaksion që nuk kualifikohet për çregjistrim (shiko paragrafët 28–30), njësia duhet të japë informacion shpjegues për secilën nga klasat vijuese të aktiveve financiare: (a) natyrën e aktiveve; (b) natyrën e risqeve dhe përfitimeve nga zotërimi ndaj të cilave njësia mbetet e ekspozuar; (c) vlerat kontabël të aktiveve dhe të çdo detyrimi përkatës, që njësia vazhdon t'i njohë.
	<i>Kolaterali</i>
41.	Kur një njësi ka vendosur aktive financiare si kolateral për detyrimet ekzistuese ose detyrimet e kushtëzuara, ajo duhet të japë informacion shpjegues si më poshtë: (a) vlerën kontabël të aktiveve financiare të vendosura si kolateral. (b) afatet dhe kushtet e kolateralit.
	<i>Mospagesat dhe shkeljet në huatë e pagueshme</i>
42.	Për huatë e pagueshme të njohura në datën e raportimit për të cilat ka pasur shkelje të afateve ose mospagim të principalit, interesit, apo shkelje të kushteve të shlyerjes që nuk janë korrigjuar në datën e raportimit, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues si vijon: (a) detajet e kësaj shkelje ose mospagese; (b) vlerën kontabël të huave të pagueshme në datën e raportimit; (c) nëse shkelja ose mospagesa është korrigjuar, ose nëse afatet e huasë së pagueshme janë rinegociuar, përpara se pasqyrat financiare të aprovoheshin për publikim.
	<i>Zëra të të ardhurave, shpenzimeve, fitimeve ose humbjeve</i>
43.	Një njësi duhet të japë informacion shpjegues për zërat vijues të të ardhurave, shpenzimeve, fitimeve ose humbjeve: (a) të ardhurat, shpenzimet, fitimet ose humbjet, nga: (i) aktivet financiare të matura me koston e amortizuar. (ii) detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar. (b) të ardhurat totale nga interesi dhe shpenzimet totale nga interesi (të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv) (c) shumën e çdo humbjeje nga zhvlerësimi për çdo klasë të aktiveve financiare.
43A	Njësitë ekonomike të vogla përjashtohen nga zbatimi i paragrafëve 38-43.
SKK 4	INVENTARËT
	SHËNIMET SHPJEGUESE
34.	Në informacionet plotësuese të pasqyrave financiare në lidhje me inventarët duhet të paraqitet informacioni i mëposhtëm: (a) politikat kontabël të përdorura si dhe formulat e përdorura për llogaritjen e koston; (b) vlerën kontabël të të gjithë zërave të inventareve/inventarëve; si dhe vlerën kontabël të tyre sipas klasifikimit të bërë nga njësia ekonomike; (c) vlerën e inventarëve të njohur si shpenzim gjatë periudhës kontabël; (d) shumën e ndonjë zhvlerësimi të inventarit ose rimarrje të zhvlerësimeve të mëparshme; (e) vlerën kontabël të inventarit të dhënë si garanci; (f) vlerën kontabël të inventarëve që janë në ruajtje të palëve të tjera; (g) informacion mbi inventarin, shumat dhe nëse është e mundur për llogaritjen e vlerës, që nuk janë të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike por që janë në ruajtje të saj.

34A	Njësitë ekonomike të vogla përjashtohen nga zbatimi i pikës (f) dhe (g) të paragrafit 34.
SKK 5	AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE
	SHËNIMET SHPJEGUESE
108.	Në pasqyrat financiare shpjegohen bazat e matjes të përdorura për përcaktimin e vlerës kontabël bruto (e aplikueshme vetëm për AAM), metodat dhe normat e amortizimit (ose jeta e dobishme), të përdorura për amortizimin e të gjitha grupeve të AAM dhe AAJM, analiza e ndryshimit në vlerën kontabël të tyre, si dhe rakordimi i informacionit të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> (a) kosto, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fillim të vitit ushtrimor; (b) blerjet dhe përmirësimet gjatë periudhës kontabël; (c) shtesat nga kombinimet e bizneseve; (d) shpenzimet e amortizimit; (e) zvogëlimet nga humbjet prej zhvlerësimit; (f) rimarrjet e humbjeve të mëparshme nga zhvlerësimi; (g) daljet jashtë përdorimit/shitjet; (h) riklasifikimet (duke përfshirë aktivet afatgjata të mbajtura për shitje); (i) ndryshime të tjera; (j) kosto, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fund të periudhës kontabël. <p>Ky rakordim nuk duhet të paraqitet për periudhën e mëparshme.</p>
109.	Gjithashtu, njësia-njësitë ekonomike, përjashtuar njësitë ekonomike të vogla , do të japë-japin informacionet e mëposhtme: (a) Vlera kontabël e elementeve të AAM dhe AAJM, të mbajtura peng si garanci për huamarrjet, apo në të cilat njësia ekonomike ka një titull të kufizuar; (b) shuma e angazhimeve kontraktore për blerjen e tokës, ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve.
114.	Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese në vijim për të gjitha aktivet afatgjata të investuara: <ul style="list-style-type: none"> (a) metodat dhe supozimet e rëndësishme të përdorura në përcaktimin e vlerës së drejtë të aktiveve afatgjata të investuara; (b) shkallën në të cilën vlera e drejtë e aktivitet afatgjatë të investuar (siç është matur apo dhënë informacioni shpjegues në pasqyrat financiare) është bazuar në një vlerësim të bërë nga një ekspert i pavarur që ka një kualifikim profesional të njohur dhe përkatës dhe përvojën e fundit në vendin dhe klasën e aktivitet afatgjatë të investuar që është duke u vlerësuar. <p>Nëse nuk ka pasur vlerësim të tillë, duhet të jepet informacion shpjegues për këtë fakt;</p> <ul style="list-style-type: none"> (c) ekzistencën dhe shumën e kufizimeve për mundësinë e realizimit të aktivitet afatgjatë të investuar apo remitancat e të ardhurave nga dalja jashtë përdorimit; (d) detyrimet kontraktuale për blerjen, ndërtimin dhe zhvillimin e aktivitet afatgjatë të investuar ose për riparime, mirëmbajtje apo zgjerime; (e) rakordimin ndërmjet vlerave kontabël të aktiveve afatgjatë të investuar në fillim dhe në fund të periudhës, duke i treguar veçmas: <ul style="list-style-type: none"> (i) shtesat, duke dhënë informacion shpjegues në mënyrë të veçantë për ato shtesa që rrjedhin nga blerjet nëpërmjet kombinimeve të biznesit; (ii) fitimet ose humbjet neto nga rregullimet e vlerës së drejtë; (iii) transferimet në toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje, kur nuk është më e disponueshme një masë e besueshme e vlerës së drejtë, pa kosto apo përpjekje të panevojshme; (iv) transferimet në dhe nga inventarët apo pasuri e zotëruar nga pronari; (v) ndryshime të tjera.

	Ky rakordim nuk duhet të paraqitet për periudhat e mëparshme.
114A	Njësitë ekonomike të vogla, nëse nuk zgjedhin të zbatojnë modelin e vlerës së drejtë për aktivet e investuara, përjashtohen nga zbatimi i pikës (a), (b), (c) dhe (e.ii) të paragrafit 114.
SKK 9	KOMBINIMET E BIZNESEVE DHE KONSOLIDIMI
	SHËNIMET SHPJEGUESE
	<i>Për kombinime biznesi të realizuara gjatë periudhës raportuese</i>
59.	Për çdo kombinim biznesi që kryhet gjatë periudhës, blerësi do të japë informacione shpjeguese në vijim: (a) emrat dhe përshkrimet e njësive ekonomike ose bizneseve të kombinuara; (b) datën e blerjes; (c) përqindjen e instrumenteve të kapitalit të zakonshëm të blerë; (d) koston e kombinimit dhe një përshkrim të përbërësve të kësaj kostoje (si mjete monetare, instrumente kapitali dhe instrumente borxhi); (d) shumat e njohura në datën e blerjes për çdo klasë të aktiveve të njësive të blerë, detyrimet dhe detyrimet e kushtëzuara, duke përfshirë emrin e mirë; (f) shumat e tepërta të njohura në fitim ose humbje në përputhje me paragrafin 32 dhe nënzhërin në pasqyrën e të ardhurave në cilin është njohur teprica.
	<i>Për të gjitha kombinimet e biznesit</i>
60.	Një blerës do të japë informacion shpjegues për rakordimin e vlerës kontabël të emrit të mirë në fillim dhe në fund të periudhës raportuese, duke treguar veçmas: (a) ndryshimet që lindin nga kombinimet e biznesit të ri; (b) humbjet nga zhvlerësimi; (c) nxjerrjet jashtë përdorimi të bizneseve të fituara më parë; (d) ndryshimet e tjera. Ky rakordim nuk duhet të paraqitet për periudhat e mëparshme.
60A	Në shënimet e pasqyrave financiare shpjegohen: - metodat e përdorura për llogaritjen e vlerës së emrit të mirë në kombinimin e biznesit; - çdo ndryshim i rëndësishëm i vlerës së tij në raport me vitin paraardhës financiar.
	<i>Njësitë e kontrolluara</i>
	<i>Dhënia e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare të konsoliduara</i>
61.	Në pasqyrat financiare të konsoliduara duhen bërë deklaratimet e mëposhtme: (a) fakti që pasqyrat janë pasqyra financiare të konsoliduara; (b) baza për arritjen në konkluzionin se kontrolli ekziston kur shoqëria mëmë nuk zotëron, direkt ose indirekt përmes njësive të kontrolluara, më shumë se gjysmën e fuqisë votuese; (c) çdo ndryshim midis datave të raportimit të pasqyrave financiare të shoqërisë mëmë dhe njësive të kontrolluara prej saj të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara; (d) natyrën dhe shtrirjen e çdo kufizimi domethënës (p.sh, që rezultojnë nga marrëveshjet e huamarrjes ose kërkesat rregullatore) mbi aftësinë e njësive të kontrolluara për t'i transferuar fonde shoqërisë mëmë në formën e dividendëve ose për t'i ripaguar huatë.
61A	Njësitë ekonomike të vogla, që zgjedhin të hartojnë pasqyra të konsoliduara, zbatojnë kërkesat e shënimeve shpjeguese të paragrafëve 59-63.
SKK 11	TATIMI MBI FITIMIN

	SHËNIMET SHPJEGUESE
38.	Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues që i jep mundësi përdoruesve të pasqyrave të saj financiare për të vlerësuar natyrën dhe efektin financiar të pasojave tatimore aktuale ose të shtyra të transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera të njohura.
39.	Një njësi ekonomike duhet të deklarojë veçmas përbërësit më kryesorë të shpenzimeve (të ardhurave) tatimore. Përbërës të tillë të shpenzimeve (të ardhurave) tatimore mund të përfshijnë: (a) shpenzimet (të ardhurat) tatimore aktuale; (b) çdo rregullim i njohur në periudhën raportuese për tatimin aktual të periudhave të mëparshme; (c) shumën e shpenzimit (të ardhurës) tatimore të shtyrë, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferencave të përkohshme; (d) shumën e shpenzimit (të ardhurës) tatimore të shtyrë që ka të bëjë me ndryshimet në normat tatimore ose aplikimin e tatimeve të reja; (e) efektin në shpenzimet tatimore të shtyra që lindin nga një ndryshim në rezultatet e mundshme të një rishikimi nga autoritetet tatimore (shiko paragrafin 31); (f) rregullimet në shpenzimet tatimore të shtyra që lindin nga një ndryshim në statusin tatimor të njësisë ekonomike ose aksionarëve/ortakëve të saj; (g) çdo ndryshim në shumën e provizionit (shiko paragrafët 28 dhe 29); (h) shumën e shpenzimit tatimor që ka të bëjë me ndryshimet në politikat dhe gabimet kontabël (shih SKK 1 Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare).
40.	Një njësi ekonomike duhet të deklarojë veçmas si vijon: (a) shumat totale të tatimeve aktuale dhe të shtyra, që kanë të bëjnë me zërat e ngarkuar ose kredituar drejtpërdrejt në kapital; (b) një shpjegim të diferencave më kryesore midis vlerave të paraqitura në kapital dhe vlerave të raportuara tek autoritetet tatimore; (c) një shpjegim të ndryshimeve në normën(at) e zbatueshme tatimore krahasuar me periudhën paraardhëse raportuese; (d) për çdo lloj diference të përkohshme dhe për çdo lloj humbje tatimore ose tatimi të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur: (i) vlerën e detyrimeve tatimore të shtyra, aktiveve tatimore të shtyra dhe të provizionit në fund të periudhës raportuese dhe; (ii) një analizë të ndryshimit në detyrimet tatimore të shtyra, aktivet tatimore të shtyra dhe provizionit gjatë periudhës. (e) datën e skadimit, nëse ka, të diferencave të përkohshme, humbjeve tatimore dhe tatimeve të zbritshme (rimbursueshme) të papërdorura; (f) në rrethanat e përshkruara në paragrafin 32, një shpjegim të natyrës së pasojave të mundshme tatimore që mund të rezultojnë nga pagesa e dividendëve ndaj aksionerëve të njësisë.
40A	Nëse njësitë ekonomike të vogla që zgjedhin të aplikojnë lehtësimin e parashikuar në paragrafin 4 të këtij Standardi, i zbatojnë kërkesat e paragrafëve 38-40 të pjesshme, për aq sa ato kanë të bëjnë me tatimin aktual. Në të kundërt, nëse njohin tatime të shtyra, atëherë duhet të paraqesin në shënimet shpjeguese të gjitha sa kërkohen në paragrafët 38-40.
SKK 13	Aktivitet biologjike dhe marrëveshjet konçesionare
	SHËNIMET SHPJEGUESE
	<i>Shënimet shpjeguese për aktivet biologjike</i>
	<i>Aktivitet biologjike të mbajtura me vlerë të drejtë</i>
29A-	Nëse njësitë ekonomike të vogla zgjedhin të mbajnë aktivet biologjike me vlerë të drejtë, në shënimet shpjeguese të pasqyrat-pasqyrave financiare duhet të jepet i plotë informacioni i kërkuar në paragrafin 29.
	<i>Aktivitet biologjike të mbajtura me kosto</i>
30.	Në pasqyrat financiare duhet të jepet informacioni i mëposhtëm, në lidhje me aktivet biologjike të matura me modelin e koston: (a) një përshkrim të çdo klase të aktiveve biologjike; (b) një shpjegim se përse vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme; (c) metodën e përdorur të amortizimit; (d) jetët e dobishme ose normën e përdorur të amortizimit; (e) vlerën kontabël bruto dhe amortizimin e akumuluar (së bashku me humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë) në fillim dhe në fund të periudhës.

30A	Njësitë ekonomike të vogla, që nuk zgjedhin të mbajnë aktivet biologjike me modelin e vlerës së drejtë, përjashtohen nga zbatimi i pikës (b) të paragrafit 30.
SKK 15	PËR KONTABILITETIN DHE RAPORTIMIN FINANCIAR TË MIKRONJËSIVE EKONOMIKE
	SHËNIMET SHPJEGUESE
58.	<p>Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare përfshijnë gjithashtu:</p> <p>(a) Përshkrimin e veprimtarisë të mikronjesisë dhe aktivitetin e saj kryesor;</p> <p>(b) Referencat e standardeve të kontabilitetit të përdorura për të përgatitur pasqyrat financiare;</p> <p>(c) Shpjegimet mbi politikat kontabël të inventarëve;</p> <p>(d) Shpjegimet mbi aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara;</p> <p>(e) Ndonjë informacion tjetër të rëndësishëm për të kuptuarit e pasqyrave financiare.</p>